L I G J
Nr.8738, datë 12.2.2001

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8378, DATË 22.7.1998,
"KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" në nenin 121 pika 5, në fund të rreshtit të dytë pas fjalëve "para vitit 1974," shtohen fjalët "dhe ka punuar në ndërmarrjet dhe sektorët e transportit për më shumë se pesë vjet ose që ka qenë drejtues autoshkolle mbi pesë vjet,".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2905, datë 20.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani